

## AKTI I THEMELIMIT

### I shoqerise tregtare me pergjegjesi të kufizuar: “Musa Construction” Sh.p.k.

#### NENI 1

Ne Sarande sot me 13.08.2024 shtetasi i poshteshenuar, me vullnet te lire dhe te plote krijone shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar:

“Musa Construction” Sh.p.k.

#### NENI 2

Selia Qendrore e shoqerise: “Musa Construction” Sh.p.k. do te jete ne adresën: Vlore, Sarande, Lagjja nr.4, Ndertese me nr. pasurie 5/175, Zk.8642.

#### NENI 3

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte pa afat te percaktuar, duke filluar afati nga dita e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Me vendim të Asamblese se Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim Q.K.B. per të bere shenimet e nevojshme.

#### NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare: “Musa Construction” Sh.p.k. do te jete:

Ne fushen e ndertimit, si dhe germimi dhe transporti i dherave.

#### NENI 5

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100,000 leke (njqind mije) leke, formuar dhe nenshkruar nga 1 ortak ose 1 kuote .

- Ortaku themelues: ARJANA MUSA: Zoteruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 (njqind mije) Lekë që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaket kane pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronesie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge të ligjshme.

Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

#### NENI 6

Kapitali Themeltar i shoqerise mund të rritet ose zvogelohet, mbi bazen e vendimit me shkrim qe merr Asambleja e Ortakeve, i cili nenshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bere dhe shenimet ne regjistrin perkates. Ne keto raste, vendimi merret nga ortaket qe perfaqesojne 100% te kuotave te kapitalit themeltar.

#### NENI 7

Ortakët duhet të bëjnë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajnë sekretin e saj dhe të mos të demtojnë interesat e personave të tjerë të shoqërisë.

#### NENI 8

Shoqëria cel llogari bankare në lekë dhe në çdo lloj valute të huaj, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

#### NENI 9

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1-Asambleja e Ortakëve

2-Administratori

Kompetencat e Asamblese së Ortakëve dhe Administratorit do të përcaktohen në statutin e shoqërisë tregtare “**Musa Construction**” Sh.p.k.

#### NENI 10.

Shoqëria do të drejtohet nga 1 Administrator për një afat 5 vjeçar:

Administratore do të jetë: Znj. ARJANA MUSA

#### NENI 11

Çdo mosmarrveshje apo konflikt që mund të lind gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht ortakët duhet ta zgjidhin me mirekuptim, në të kundërtën kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### NENI 12

Shoqëria deklarohej e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, vecanërisht me ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” (të ndryshuar).

#### NENI 13

Ky akt themelimi do të hyjë në fuqi pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

#### NENI 14

Akti i themelimit u përpilua në 2 (dy) kopje dhe u nënshkrua rregullisht nga ortakët themelues.

**Themeluesi i shoqërisë**

**ARJANA MUSA**

